


Bojana Dujković – Bllagojević

Jeta shkollore në Mbretërinë Jugosllave





Pyetja kyçe

Cilat ishin aspektet e mira dhe cilat aspektet e këqija të sistemit shkollor në Jugosllavi?

Tema

Ky modul ka të bëjë me arsimin në Mbretërinë Jugosllave, në periudhën nga vitit 1918 deri më 1941, në mënyrë më specifike për pozitën e fëmijëve në sistemin edukativ.

Kjo temë është zgjedhur sepse, besoj është e ngjashme për nxënësit sot dhe mund të jetë interesante për punë. Raporti i nxënësve përballë shkollës dhe obligimeve, por gjithashtu të drejtat që i kishin fëmijët, ishin mjaft të ndryshme sesa sot.

Tema është kontroverse nga aspekti i të drejtave të fëmijëve – tani dhe atëherë. Synimi është të tregohet sa janë ndryshuar raportet gjatë 80 viteve të fundit.

Tema është relevante për tërë regjionin sepse u referohet të gjitha vendeve të Mbretërisë Jugosllave dhe tregon dallimet mes nxënësve brenda sistemit të njëjtë edukativ.

Rezultatet e mësimit

Kuptimi i pozitës së të rinjve në sistemin shkollor të Jugosllavisë para Luftës së Dytë Botërore.

1. Nxënësit do të zhvillojnë shkathtësi për ndjeshmëri.
2. Nxënësit do të bëjnë vlerësimin e burimeve historike në kuptim të vërtetësisë së tyre (dokumentet zyrtare përkundër historisë gojore, etj).
3. Ata do t'u qasen dallimeve dhe ngjashmërive dhe do ta krahasojnë sistemin shkollor në të kaluarën dhe sot.
4. Nxënësit do t'i interpretojnë burimet dhe do të bëjnë analiza për çështjet gjinore në sistemin shkollor.

Qëllimet

Njohja me rolin edukativ dhe mësues të shkollës në Mbretërinë Jugosllave. Inkurajimi i diskutimit për rolin e sistemit arsimor të sotëm për zhvillimin e të rinjve në rrethanat e ndryshuara shoqërore.

Udhëzime për mësuesin

Mësuesi nxënësve ua lexon hyrjen dhe klasës ia prezanton temën e orës. Punësoria ka dy faza – faza e parë është puna individuale në çifte, ndërsa faza e dytë është puna në grupe dhe prezantimi i rezultateve.

Orientimi kohor:

HAPI 1: Hyrje (kontekstualizim) – mësuesi lexon hyrjen, pastaj Burimin 1 dhe e tregon fotografinë e nxënësve (Burimin 2). Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara.

HAPI 2: Punë individuale – Analiza e fotografike dhe mbushja e tabelës – Burimet 3, 4 dhe 5 janë dhënë në hartë. **Burimi nr. 3:** Jablanica (B&H), Omer Karic dhe tjerë., *Jablanica 100 godina skolstva (1903-2003)*, Jablanica 2003. **Burimi nr. 4:** Prizren (Kosovë), 1945-1950, Arkivi regjional historik Prizren, Fondi Gjymnazi Real Plotësues Shtetëror, njësisia org. Prizren vitit 1949-1950. **Burimi nr. 5:** Karlovac (Kroaci) 1930, foto private familja Veseliq.

Nxënësit duhet t'i plotësojnë vendet e zbrazëta. Mësuesi përgjithësisht do të kërkojë nga nxënësit të tregojnë çka ndjejnë dhe të shpjegojnë pse kanë vendosur kështu. Në fund të aktivitetit mësuesi u jep nxënësve informata për burimet (ku janë bërë fotografitë, në cilin vend dhe kur). Pyetje të propozuara për diskutim:

- A ka dallime mes nxënësve nëpër fotografitë?
- Si duken nxënësit?
- Cila mund të jetë arsyeja kryesore për dallimet mes nxënësve?
- Si është sot? A ka dallime të rëndësishme mes studentëve të moshës tuaj?

HAPI 3: Punë në grupe – leximi i burimeve dhe analiza e lëndëve shkollore – 15 minuta. Nxënësit punojnë në grupe. Detyra është t'i analizojnë burimet 6 dhe 7 dhe ta plotësojnë tab2 (t) 0.20.2 (s1 0-205.60.2.2 (u) -0.2 d60.2 □4.2 (ë.2



45
minuta


Hyrje

Shkolla në të kaluarën, si edhe sot, shkolla ka qenë vendi qendror i arsimimit të fëmijëve. Edhe pse roli i saj edhe deri sot ka qenë i njëjtë, obligimet e fëmijëve, mënyra e punës, lëndët shkollore, por edhe mënyra e veshjes janë ndryshuar gjatë kohës. Në këtë punëtori do të tregojmë si ishte të jesh nxënës në gjysmën e parë të shek. XX në Ballkan. Si fëmijët e dikurshëm, gjyshet dhe gjyshërit e prindërve tuaj, shkonin në shkollë kur ishin të vegjël dhe çka mësonin, por edhe si duhej të silleshin. Këtë do të mundohemi t'ua prezantojmë në këtë punëtori.

Burimi 1

SHKOLLA – SHTËPIA MBI SHTËPI ...

“Së pari më habiti vet shkolla, ishte një ndërtesë dykatëshe. Shih gjysh, shkolla është shtëpi mbi shtëpi! Mendova se një shtëpi është vendosur përmbi tjetrën, sepse shtëpi me kat asnjëherë më parë nuk kisha parë. Në mësonjëtorë më shumë më befasoi globi. E pyes njërin çka është kjo, ai thotë shalqi. Pyes: Çka lypën shalqiri lartë në orman? Ai mua: E mbrojnë nga hajdutët siç je ti! E pyes njërin për tabelën me tre këmbë, për të cilën tha se nuk është asgjë, ndërsa përd 43.5 () -tj17. 0 0ë



Shiko në fotografi dhe përgjigju pyetjeve në tabelë.
Cilat ishin dallimet kryesore mes këtyre fotografive?

Burimi **1**

JABLLANICA ((Bosnje dhe Hercegovinë))

Nga cila periudhë kohore është kjo fotografi?

Cila është mosha e fëmijëve në fotografi?



Si janë të veshur fëmijët në fotografi?

Çka tregohet në fotografi?

Burimi **2**
PRIZRENI (Kosovë)

Nga cila periudhë kohore është kjo fotografi?

Cila është mosha e fëmijëve në fotografi?



Si janë të veshur fëmijët në fotografi?

Çka tregohet në fotografi?

Burimi **3**
KARLOVAC (Kroaci)

Nga cila periudhë kohore është kjo fotografi?

Cila është mosha e fëmijëve në fotografi?



Si janë të veshur fëmijët në fotografi?

Çka tregohet në fotografi?

Detyra 3

Punë në çifte

1. Gjeji dallimet në listën e lëndëve në vitin 1926 dhe 1939.
2. Sa dallime ka?
3. Mbushe tabelën – shënoji ngjashmëritë dhe dallimet kryesore mes lëndëve shkollore që punoheshin në shkollë në të kaluarën dhe në kohën tuaj, por gjithashtu çka mendoni se fëmijët tuaj do të mësojnë në të ardhmen.

Burimi 1

Lëndët shkollore në vitin 1926.

1. Shkenca për fenë dhe moralin
2. Gjuhë serbo-kroate-slovene
3. Mësim real fillestar
4. Gjeografia
5. Historia e serbëve, kroatëve dhe slovenëve
6. Algjebër me gjeometri
7. Dituri natyre
8. Vizatim
9. Bukurshkrim
10. Punë dore, për meshkuj dhe për femra
11. Këndim
12. Gjymnastikë dhe lojëra fëmije

M. Papić, Školstvo u BiH 1918 - 1941, Sarajevo 1984.

Burimi 2

Lëndët shkollore në vitin 1939.

1. Bontoni
2. Shkenca për fenë dhe moralin
3. Gjuhë serbo-kroate
4. Mësim real fillestar
5. Gjeografi
6. Histori popullore
7. Algjebër me gjeometri
8. Dituri natyre
9. Dituri dhe shkathtësi praktike dhe ekonomike
10. Vizatim
11. Bukurshkrim
12. Punë dore
13. Këndim
14. Gjymnastikë dhe lojëra fëmije

Jurica Marinko, 1. 9. 1939, Banovina Hrvatska, Srez Dubrovnik. Privatna arhiva.

	LËNDËT KRYESORE	SHKATHTËSI
Mbretëria Jugosllave		
Vendi im 2013+		
Ardhmëria		

Burimi 1

Ndëshkimi fizik i fëmijëve

“Lloji i ndëshkimit varej nga mësimehmënësi. Ndëshkimet fizike mësimehmënësit i bënin kryesisht me shkop. Për goditje në duar dhe në vithe mësimehmënësi zgjidhte thupër të hollë të lakueshme, e cila vështirë thyhej. Nxënësi rrihej në shuplaka ose mbështetej në karrige, e shtrëngonte me dorën e majtë për pantallonat, ndërsa me të djathtën e godiste. Goditej edhe me vizore në majë të thonjve të gishtave të mbledhur. Ishte në traditë ndeja në gjunjë, qëndrimi anash bankës ose në skaj... Prindërit shumë rrallë ankoheshin kundër këtyre dënimeve”.

Svjedočanstvo ing. Omanovića, koji je išao u narodnu osnovnu školu u Cazinu devedesetih godina XIX vjeka.
M. Papi, *Školstvo u BiH za vrijeme Austro-Ugarske 1878-1918*, Sarajevo 1972, str. 178.

Burimi 2

Llojet e ndëshkimit

“Mësimehmënësit në shkollë e mbanin disiplinën me punën dhe shembullin e tyre personal, ndërsa nëse kjo nuk arrinte sukses në të gjitha rastet, atëherë neglizhencën ndaj të mësuarit, parregullsinë dhe sjelljen e keqe e dënonin me dënime fizike edhe në mënyra të tjera të ndryshme... Zakonisht dënimet fizike kryheshin me thupër, ndërsa përveç kësaj ekzistonte edhe dënimi me mbyllje, gjunjëzim, qëndrim etj... Prindërit nuk e pengonin dënimin fizik të fëmijëve të tyre”.

V. Bogi evi, *Istorija osnovnih škola u BiH (1878 – 1918)*, str. 213

Burimi 3

Dënimi me “shkop”



Milanka Todić, *Istorije srpske fotografije 1839-1940*, Prosveta, Beograd, 1993.
http://www.udi.rs/articles/Milanka%20Todic_Istorija%20srpske%20fotografije%201839-1940.pdf
Downloaded November 1st 2012.

MBRETËRIA JUGOSLLAVE	VENDI IM
NGJASHMËRITË	DALLIMET
Burimi 1	
Burimi 2	
Burimi 3	

Burimi 1

Inkuadrimi i fëmijëve femra në sistemin shkollor

“Që në kohën e Austro-Hungarisë në Bosnjë dhe Hercegovinë janë zhvilluar mjaft diskutime në publikun kulturor për shkollimin në përgjithësi, por edhe për shkollimin e fëmijëve femra. Megjithatë, mendohej se, kështu del sipas asaj që është shkruar, që femra është e paracaktuar për amvisëri dhe vetëm për disa profesione në lidhje me kujdesin ndaj fëmijëve. Kështu kaluan plot 40 vite të punës së gjimnazit, e në të nuk u regjistrua asnjë nxënëse... Femrat shumë ngadalë dhe turpshëm inkuadroheshin në shkollimin e rregullt në gjimnaz. Me dhënien e provimeve private, dhe kjo gjatë viteve të fundit të okupimit, filluan t'i marrin dijet e para nëpër gjimnaze femrat e para në Bosnjë dhe Hercegovinë. Qeveria vendore në gusht të vitit 1918 lejoi që nxënëset të cilat privatisht e kishin kaluar vitin e parë dhe të dytë të regjistrohen në vitin e tretë. Pas Luftës së Parë Botërore më në fund u hoq ky kufizim dhe nxënëset filluan të regjistrohen në gjimnaz, edhe atë në fillim vetëm në klasat e posaçme të vajzave”.

M. Papić, Školstvo u BiH 1918 - 1941, Sarajevo 1984, str. 114

Burimi 2

Shkolla zejtare e vajzave

Lëndët:

1. Punë profesionale praktike
2. Vizatimi i qepjeve
3. Gjuhë serbokroate-slllovene
4. Llogaritje, kontabilitet zejtar dhe kalkulum
5. Njohja e mallit dhe amvisërisë
6. Histori dhe gjeografi
7. Vizatim dekorativ
8. Mësim fetar
9. Higjienë
10. Gjymnastikë
11. Këndim

Zoran Ivanovi, Zvornički spomenar, Prometej, Novi Sad, 2002.

Burimi 3

Nxënëset e shkollës profesionale të vajave



MBRETËRIA JUGOSLLAVE	VENDI IM
NGJASHMËRITË	DALLIMET
Burimi 1	
Burimi 2	
Burimi 3	

Burimi 1

Obligimet e punës së nxënësve

"Në shkollë punonin mësimdhënësit Mirjana dhe Spasan Todiq, ndërsa drejtues i shkollës ishte Ivo Kraljeviq. Çifti i mësimdhënësve Todiq dhe drejtuesi Kraljeviq banonte në banesë që gjendeshin në ndërtesën e shkollës. Nxënësit nëpër klasat mësonin nga dy klasa (klasa I dhe III, dhe II dhe IV bashkërisht). Krahës mësimi nxënësit punonin në ekonominë e shkollës, prandaj oborri, kopshti dhe pemishtja ishin mjaft të rregulluara. Mësimdhënësit mbanin bagëti, veçanërisht dele dhe derrë. Puna në oborrin e shkollës nuk ishte e rëndë, por për nxënësit ishte përgjegjësi dhe obligim... Prindërit ishin të obliguar që shkollës t'i siguronin drunjt për ngrohje. Ata zotë shtëpie të cilët nuk kishin një ngarkesë me dru, i çanin drunjtë, ndërsa nxënësit i rendisin drunjtë... Në shkollë qëndrohej gjatë dhe secili nxënës në çantë mbante diçka për të ngrënë. Mësimi fetar ishte të enjten, ndërsa të premten shkolla nuk punonte sepse mësimdhënësit shkonin në qëndrën e komunës ose qarkut. E shtuna ishte ditë pune".

Sje anja Mi i (or a) Nedeljko – 100 godina
osnovne kole u Boljani u, Doboj 1996, str.
78

Burimi 2

Shkolla e mësuesve në Banja Llukë, Urdhëresë për fillimin e vitit shkollor 1930/31.

“...Në internat do të pranohen nxënësit e varfër me sukses dhe sjellje mjaft të mirë, nëse ka vende, për qëndrim dhe ushqim, ndërsa një numër i konsiderueshëm i nxënësve do të pranohen vetëm për ushqyerje... Edhe gjatë kohës së pushimeve shkollore silluni në mënyrë korrekte, përhapini shkrimin dhe leximin, luftojeni alkoolizmin dhe ateizmin”.

Vrbaske novine, br 35, od 24. jula 1930, str 10.

Burimi 3

Sjellja e nxënësve jashtë shkollës

“Nga fundi i dekadës së tretë të shek. XX, nxënësit e Shkollës Qytetare në Banja Llukë e kishin të obligueshme të mbajnë kapela dhe uniforma shkollore. Lëvizja e nxënësve në rrugë ishte e lejuar vetëm deri në orën 20:00. Nëse ndonjë mësues e takonte nxënësit në rrugë pas kësaj kohe, ai nxënës mernte vërejtje nga këshilli i mësimdhënësve ose ndonjë dënim tjetër”.

Olga Kunaica, 1928 – 2013. Interviewed in October 2011.

Burimi 4

Roli edukativ i shkollës

"Gjimnazet, krahas rolit arsimor, luanin edhe një rol tjetër mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e të rinjve – rol edukativ. Në to disiplina ishte në nivel mjaft të lartë. Uniforma shkollore mbahej edhe jashtë shkollës, ndërsa ata nxënës të cilët vëreheshin nga profesorët e tyre jashtë shtëpive të tyre në orët e vona të natës, dënoheshin me vërejtje".

Ж С 1918-1941; П А К , С
Х , Т Г : М С

MBRETËRIA JUGOSLLAVE	VENDI IM
NGJASHMËRITË	DALLIMET
Burimi 1	
Burimi 2	
Burimi 3	